



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 220/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “BACI-EL 2003” SHPK, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-89315-03-08-2021, me objekt: “Blerje pllaka varri për Agjensinë e Shërbimeve Publike”, me fond limit 4.198.520 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 19.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:** “AGED” SHPK.  
Adresa: Lagjja “Çlirim”, Rruga “Ali Cungu”, Poligoni pranë Varrezave Publike, Elbasan.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Elbasan.  
Adresa: Rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1, të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.03.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF-89315-03-08-2021, me objekt: “*Blerje pllaka varri për Agjensinë e Shërbimeve Publike*”, me fond limit 4.198.520 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 19.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

II.2. Në datën 19.03.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 07.04.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “BACI-EL 2003” SHPK	3880	kualifikuar
2. “ZEQIRI” SHPK	4160	kualifikuar
3. “AGED” SHPK	4240	kualifikuar

II.4. Në datën 07.04.2021, operatori ekonomik “AGED” SHPK është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe kualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Operatori ekonomik “AGED” SHPK, në datën 13.04.2021 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorëve ekonomikë “BACI-EL 2003” SHPK dhe “ZEQIRI” SHPK, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

*Autoriteti kontraktor më datë 07/04/2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:*

1. BACI EL 2003 SH.P.K	3880	JO
2. ZEQIRI	4160	JO
3. AGED	4240	JO

*Shoqëria "AGED" SHPK me aktivitet Prodhim Materiale Ndërtimi ka në pronësi të saj Poligonin e Prodhimit ngjitur me rrethimin e Varrezave Publike Elbasan, (në Jug të varrezave). Ka mbi 15 vite që furnizon me Pllaka Varri ASHP Bashkia Elbasan konform standardit të kontratave. Ka krijuar një eksperiencë të mirë me specialistë të kualifikuar, gjithashtu ka ngritur Repartin e Prodhimit të Zgarave të Hekurit me Pikatrice (elektrokontakt). Ka në pronësi të saj mbi 3000 m2 sheshe me beton për prodhimin e pllakave si dhe Nyjen e prodhimit të Betonit.*

*Vitin e kaluar çuditërisht del fitues Firma "ZEQIRI" në Fier që është gati 90 km larg nga Elbasani. Si pasojë na mbeten gjendje nga viti i kaluar mbi 400 komplete. Kjo ishte dhe një nga arsyet që këtë vit paraqitëm një çmim të ulët.*

*Lidhur me kualifikimin nga ana juaj të dy Firmave që kanë vlerën më të ulët se ne ankimojmë si më poshtë:*

1. Firma ZEQIRI ka shkelur rendë Kontratën e vitit të kaluar për furnizimin me Pllaka Varresh ku sipas Shtojcës 6 Deklaratë Mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike, ka prodhuar pllaka (kapakët e mbulimit 80 x 33 x 5 cm) jashtë kushteve teknike me dy fije më pak hekur gjatësor 80 cm (nga 4 fije që duhen janë me dy fije) dhe trashësi të saj më pak se 5 cm. Janë dëmtuar shumë pllaka që i kemi konstatuar në vete gjithashtu dhe nga ankimet e punëtorëve të Varrezave. Kapakët e mbulimit mbajnë rreth 1 m3 "Dhe" sipër në mbulimin e varrit. Si pasojë ka pasur thyerje të shumta gjatë mbulimit. Kjo është shkelje e rëndë dhe me përgjegjësi ligjore.

a. Nuk ka shoqëruar me deklaratë cilësie dhe analiza laboratorike furnizimet e kryera.

b. Të verifikohet nëse është lëshuar Vërtetim për Realizimin e Kontratës për vitin e kaluar dhe a është specifikuar Përmbushja e kushtit të Cilësisë.

2. Firma BACI - EL 2003 nuk ka punë të ngjashme prodhim pllaka b/a që janë struktura të holla t= 5 cm, prodhimi i të cilave ka kushte specifike,

a. Kërkon shesh prodhimi minimalisht 1000 m<sup>2</sup> për prodhim mujor të 83 komplete mbi tokë dhe 83 nën tokë për të cilat kushti teknik e ka që të qëndrojnë minimalisht 21 ditë të trajtuara në shesh për të kapur markën e betonit. Kjo sasi e prodhimit mujor plotëson kontratën e furnizimit të këtij viti me 670 komplete gjithsej.

b. Oferta që ofron kjo firmë është e pajustificueshme dhe në përputhje me çmimet e kostos se manualit të miratuar nga ish Ministria e Ndërtimit, Sektori i Standardeve të Kostos, VKM nr.708, dt.12/10/2011, analizën të cilën po jua bashkëngjisim këtij ankimimi.

c. Transporti nga Firma deri tek varrezat është rreth 6 km për të cilën ka rritje kosto prej 185 lekë për 1 komplet. Pranimi i kësaj oferte mund të realizohet vetëm duke shkelur në cilësi (shtojca 6), si dhe duke favorizuar informalitetin në punë me paga 30000 lekë në muaj dhe gjithashtu pa paguar Sigurimet (shtojca 5/1).

d. Në janar të këtij viti ka hyrë në fuqi aplikimi i pagës minimale prej 30000 leke për 22 ditë pune në muaj (paga orare 170 lekë). Pjesëmarrja me këto oferta shkatërron konkurrencën e ndershme, aq më tepër për firmë si ne që është bashkëpunuese dhe korrekte me ju prej mbi 15 vitesh.

II.6. Me anë të shkresës nr. 1762/1 prot, datë 15.04.2021, marrë në dorëzim nga operatori ekonomik ankimues më datë 21.04.2021, sipas konfirmimit të Filialit të Postës Shqiptare me shkresën nr.486/1 prot, datë 22.04.2021, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar atë sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

Sot më datë 15.04.2021, në Bashkinë Elbasan, në zbatim të Urdhrit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Nr.1165/4 prot, datë 13.04.2021, për “Krijimin e komisionit të shqyrtimit të ankesës së subjektit “AGED” sh.p.k. për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pllaka varri për Agjensinë e Shërbimeve Publike”, me fond limit: 4,198,520 (katër milion e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa t.v.sh dhe me shumatore të çmimeve për njësi 4,882 (katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa t.v.sh. i shpallur në sistemin elektronik të APP-së më datë 09.03.2021 dhe me datë zhvillimi 19.03.2021, komisioni i mbledhur për shqyrtimin e ankesës, i përbërë nga E.Sh, Y.M dhe L.T mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AGED” sh.p.k.

Komisioni pasi konstatoi se ankesa është brenda afateve ligjore vendosi të shqyrtojë në themel objektin e ankesës.

Autoriteti kontraktor më datë 07/04/2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BACI EL 2003 SH.P.K	3880	JO
2. ZEQRIRI	4160	JO
3. AGED	4240	JO

Shoqëria “AGED” SHPK me aktivitet Prodhim Materiale Ndërtimi ka në pronësi të saj Poligonin e Prodhimit ngjitur me rrethimin e Varrezave Publike Elbasan, (në Jug të varrezave). Ka mbi 15 vite që furnizon me Pllaka Varri ASHP Bashkia Elbasan konform standardit të kontratave. Ka krijuar një eksperiencë të mirë me specialistë të kualifikuar gjithashtu ka ngritur Repartin e Prodhimit të

Zgarave të Hekurit me Pikatrice (elektrokontakt). Ka në pronesi të saj mbi 3000 m<sup>2</sup> sheshe me beton për prodhimin e pllakave si dhe Nyjen e prodhimit të Betonit.

Vitin e kaluar çuditërisht del fitues Firma "ZEQIRI" në Fier që është gati 90 km larg nga Elbasani. Si pasojë na mbeten gjendje nga viti i kaluar mbi 400 komplete. Kjo ishte dhe një nga arsyet që këtë vit paraqitëm një çmim të ulët.

Lidhur me kualifikimin nga ana juaj të dy Firmave që kanë vlerën më të ulët se ne ankimojmë si më poshtë:

Në lidhje me pretendimet tuaja ju bëjmë me dije se:

1. Pretendimet tuaja për operatorin ekonomik "Zeqiri" sh.p.k., janë pretendime që nuk kanë asnjë lidhje me vlerësimin e procedurës aktuale të vitit 2021, por me zbatimin e kontratës të vitit 2020. Ky operator është kualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me datë 07.04.2021, pasi i ka përmbushur të gjitha kriteret e veçanta të përcaktuara në DST.

2. Për sa i përket pretendimeve tuaja në lidhje me operatorin ekonomik "Bari - El 2003" sh.p.k. ju bëjmë me dije se operatori ekonomik e plotëson pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik të DST për furnizime të së njëjtës natyrë.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se analiza e kostos me shpjegime për elemente të veçante të ofertës, do të kërkohej nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përpara se të bënte kualifikimin, vetëm në rast se oferta e operatorit ekonomik do të rezultonte anomalisht e ulët, sipas nenit 56 të LPP. Për aq kohë sa oferta ekonomike e operatorit ekonomik "Bari - El 2003" sh.p.k., nuk ka rezultuar anomalisht e ulët, si dhe dokumentacioni i dorëzuar prej tij, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, komisioni i vlerësimit të ofertave e ka pranuar ofertën e këtij operatori.

Sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë.

II.7. Në datën 26.04.2021 operatori ekonomik "AGED" SHPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtat pretendime si ato të parashtruara pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1144/16 prot, datë 12.04.2021, nr. 7189/1 prot, protokolluar me tonën në datë 13.04.2021, me objekt "Dërgim Informacioni për Vendimin nr. 503/I" është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "MUCA" SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatorëve ekonomikë "BACI-EL 2003" SHPK dhe "ZEQIRI" SHPK, me arsyen se: *Lidhur me kualifikimin nga ana juaj të dy Firmave që kanë vlerën më të ulët se ne ankimojmë si më poshtë:*

1. Firma ZEQIRI ka shkelur rëndë Kontratën e vitit të kaluar për furnizimin me Pllaka Varresh ku sipas Shtojcës 6 Deklaratë Mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike, ka prodhuar pllaka (kapaket e mbulimit 80 x 33 x 5 cm) jashtë kushteve teknike me dy fije më pak hekur gjatësor 80 cm (nga 4 fije që duhen janë me dy fije) dhe trashësi të saj më pak se 5 cm. Janë dëmtuar shumë pllaka që i kemi konstatuar në vete gjithashtu dhe nga ankimet e punëtorëve të Varrezave. Kapakët e mbulimit mbajnë rreth 1 m<sup>3</sup> "Dhe" sipër në mbulimin e varrit. Si pasojë ka pasur thyerje të shumta gjatë mbulimit. Kjo është shkelje e rëndë dhe me përgjegjësi ligjore.

a. Nuk ka shoqëruar me deklaratë cilësie dhe analiza laboratorike furnizimet e kryera.

b. Të verifikohet nëse është lëshuar Vërtetim për Realizimin e Kontratës për vitin e kaluar dhe a është specifikuar Përmbushja e kushtit të Cilësisë.

2. Firma BACI - EL 2003 nuk ka punë të ngjashme prodhim pllaka b/a që janë struktura të holla  $t = 5$  cm, prodhimi i të cilave ka kushte specifike,

a. Kërkon shesh prodhimi minimalisht 1000 m<sup>2</sup> për prodhim mujor të 83 komplete mbi tokë dhe 83 nën tokë për të cilat kushti teknik e ka që të qëndrojnë minimalisht 21 ditë të trajtuara në shesh për të kapur markën e betonit. Kjo sasi e prodhimit mujor plotëson kontratën e furnizimit të këtij viti me 670 komplete gjithsej.

b. Oferta që ofron kjo firmë është e pajustificueshme dhe në përputhje me çmimet e kostos se manualit të miratuar nga ish Ministria e Ndërtimit, Sektori i Standardeve të Kostos, VKM nr.708, dt.12/10/2011, analizën të cilën po jua bashkëngjisim këtij ankimimi.

c. Transporti nga Firma deri tek varrezat është rreth 6 km për të cilën ka rritje kosto prej 185 lekë për 1 komplet. Pranimi i kësaj oferte mund të realizohet vetëm duke shkelur në cilësi (shtojca 6), si dhe duke favorizuar informalitetin në punë me paga 30000 lekë në muaj dhe gjithashtu pa paguar Sigurimet (shtojca 5/1).

d. Në janar të këtij viti ka hyrë në fuqi aplikimi i pagës minimale prej 30000 leke për 22 ditë pune në muaj (paga orare 170 lekë). Pjesëmarrja me këto oferta shkatërron konkurrencën e ndershme, aq më tepër për firmë si ne që është bashkëpunuese dhe korrekte me ju prej mbi 15 vitesh", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit të modifikuara, shtojca 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 2.3.1, autoriteti kontraktor ka parashikuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

"2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:

a) Kontrata për furnizime të ngjashme të shoqëruara me "Vërtetimin nga institucioni përkatës për kontratën e realizuar", nëse furnizimi është kryer me një ent publik;

ose

- b) *Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe emri e nënshkrimi i personit blerës.”.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike prej operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK, rezulton se në përmbushje të kriterit të lartpërmendur ka dorëzuar dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë furnizimi nr. 3483/8 prot, datë 25.09.2020, të lidhur me Bashkia Elbasan, me objekt: “Komplete varre nëntokësore dhe komplete varre mbitokësore”, me vlerë 1.818.000 lekë me-TVSH.
- Kontratë furnizimi nr. 3483/11 prot, datë 15.02.2021, të lidhur me Bashkia Elbasan, me objekt: “Blerje pllaka varri për Agjencinë e Shërbimeve Publik”, me vlerë 1.132.000 lekë me-TVSH.
- *Faturën tatimore të shitjes me numër serial 81705583, datë 27.11.2020, për artikullin “Komplet pllaka varri” me vlerë 563040 lekë (pa-TVSH).*
- *Faturën tatimore të shitjes me numër serial 81705588, datë 15.12.2020, për artikullin “Komplet pllaka varri” me vlerë 451960 lekë (pa-TVSH).*
- *Faturën elektronike tatimore të shitjes me numër 3/2021, datë 18.02.2021, për artikullin “Varre mbitokësore dhe varre nëntokësore (komplet)” me vlerë 943500 lekë (pa-TVSH).*
- *Vërtetim realizimi lëshuar nga Bashkia Elbasan për shoqërinë “Zeqiri” SHPK, ku dëshmohet se kjo shoqëri i ka realizuar me sukses kontratën e lidhur më datë 25.09.2020 me vlerë 1.818.000 lekë dhe kontratën e datës 15.02.2020 me vlerë 1.132.200 lekë.*

III.1.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit... .”

III.1.4. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pika 4, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

*Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura*

*tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.*

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik thekson se interpretimi i faturave të shitjes të paraqitura nga operatori ekonomik ankimes nëse do të cilësohet si eksperiencë e ngjashme duhet parë në raport me natyrën e mallrave objekt prokurimi (zërat e preventivit) që autoriteti kontraktor synon të arrijë të kryejë në cilësinë e “investitorit”, pas lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik të klasifikuar të suksesshëm.

III.1.7. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimes se: *Firma ZEQIRI ka shkëlur rëndë Kontratën e vitit të kaluar për furnizimin me Pllaka Varresh ku sipas Shtojcës 6 Deklaratë Mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike, ka prodhuar pllaka (kapaket e mbulimit 80 x 33 x 5 cm) jashtë kushteve teknike me dy fije më pak hekur gjatësor 80 cm (nga 4 fije që duhen janë me dy fije) dhe trashësi të saj më pak se 5 cm. Janë dëmtuar shumë pllaka që i kemi konstatuar në vete gjithashtu dhe nga ankimet e punëtorëve të Varrezave. Kapaket e mbulimit mbajnë rreth 1 m3 "Dhe" sipër në mbulimin e varrit. Si pasojë ka pasur thyerje të shumta gjatë mbulimit. Kjo është shkelje e rëndë dhe me përgjegjësi ligjore.*

a. *Nuk ka shoqëruar me deklaratë cilësie dhe analiza laboratorike furnizimet e kryera.*

b. *Të verifikohet nëse është lëshuar Vërtetim për Realizimin e Kontratës për vitin e kaluar dhe a është specifikuar Përmbushja e kushtit të Cilësisë.*“, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se me dokumentacionin e paraqitur ofertuesi “Zeqiri” SHPK vërteton se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke dëshmuar të gjitha kapacitetet për të kryer furnizimin me mallrat e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankimesi e ka përmbushur kriterin e kualifikimit duke vërtetuar kështu se disponon kapacitetet në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese nuk qëndron.



III.3. Lidhur me pretendimet e palës ankimuese për skualifikimin e operatorëve të tjerë në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se;

III.3.1. Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elemente janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

III.3.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.3.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi se këto të fundit nuk qendrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 07.04.2021 dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK do të mbetet e kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për skualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tyre, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AGED” SHPK për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-89315-03-08-2021, me objekt: “Blerje pllaka varri për Agjensinë e Shërbimeve Publike”, me fond limit 4.198.520 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 19.03.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 702 Protokolli**

**Datë 26.04.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**